



PROCESVERBAL 10/2024

I Mbajtur në takimin e X- të të rregulltë të KPF-së me datën **28.10.2024**, në ora **10⁰⁰** në Zyrën e takimeve të Kryetari i Komunës, nën kryesimin e Kryesuesit të KPF-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtarës për informim.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. XhavitZariqi, Kryesues;
2. Arian Imeri, Anëtar
3. Lumnije Morina, Anëtare;
4. Mimoza Pajaziti, Anëtare;
5. Lulzim Abazi, Anëtar;
6. Brahim Osmani, Anëtar;
7. Shqipe Jashari, Anëtare;
8. Hatixhe Bungu Qerimi, Anëtare;
9. Flamur Istrefi, Anëtar.

Drejtoret e drejtorive;

1. Sebahate Ajeti Sadiu – Drejtore e Buxhetit dhe Financave
2. Sabri Murseli - Drejtor i Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Përsëndetje të pranishëm, anëtarë të kuvendit, shoqëria civile, Drejtor të drejtorive, pra po fillojmë me mbledhjen e X-të të rregullt të KPF-së, besoi që materialin e keni marr me kohë dhe ju dëshiroi mirëseardhje në mbledhjen e KPF-së dhe propozojë këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KK-së;

4. Propozim – Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për Vitin 2025;
5. Propozim – Vendim për lirimin – faljen e qirave për lokalitete në Rr. “Ramadan Rexhepi” në pronësi të Komunës;
6. Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator për Vitin 2024;
7. Propozim – Vendim për Miratimin e Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Plani i Veprimit për Rininë 2024-2027;
8. Propozim – Vendim për publikimin e listës së pronave të Komunës së Ferizajt për dhënie në shfrytëzim për Vitin 2025;
9. Propozim – Vendim për Këmbimin e pjesës së ngastrës kadastrale; 706-0, Z.K. Lloshkobare, pronë e Komunës së Ferizajt, me pjesën e ngastrës kadastrale 705-3 dhe 705-4 Z.K. Lloshkobare, pronë private;
10. Propozim – Vendim për Këmbimin e pjesës së ngastrës kadastrale; 992-0, Z.K. Talinoc i Muhaxherëve, pronë e Komunës së Ferizajt, me ngastrën kadastrale 376-1 dhe 378-3 Z.K. Nerodime e Ulët, pronë e Këshillit të Bashkësisë Islame Ferizaj;
11. Pyetje dhe kërkesa dhe
12. Të ndryshme.

Pika 1

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Fillojmë me pikën e I-rë të rendit të ditës, Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KPF-së, të gjithë jemi prezent.

Pika 2

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Miratimi i rendit të ditës, A ka dikush të diskutoi rreth rendit të ditës, nese nuk ka?, a jeni që të kaloi në kuvend rendi i ditës?, kush është që të kaloi pika e II-të?, faliminderit, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e III-të të rendit të ditës.

Pika 3

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të KPF-së; A ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar, nëse jo a jeni që të kaloi procesverbali i mbledhjes së kaluar?, faliminderit, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e IV-të të rendit të ditës.

Pika 4

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për Vitin 2025, a ka dikush të diskutoi për këtë rend dite, urdhëro drejtore!

Sebahate Ajeti Sadiku – Faliminderit Kryesues, a ta prezentoj si pikë?, bazuar në Ligjin Nr.08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.06/L-006 për tatimin e pronës e paluajtshme neni

9 shkalla tatimore progresive: paragrafi 4. Kuvendi i Komunës së Ferizajt cakton shkallen e aplikueshme tatimore për çdo kufi tatimor sipas paragrafit 3 të këtij neni, deri me 30 nëntor të vitit para vitit të vendosjes së tatimit. Shkallet tatimore të përcaktuara nga komuna duhet të kenë trend progresiv dhe të vendoset norma tatimore për Vitin 2025, pra vitin e kalum qeveria bëri edhe vlerësimin e ri që d.m.th e rriti vlerësimin në të gjitha komunat dhe në nivel vendi, këtë vit na obligon që të fuqizojmë normën progresive me ligjin e ri, i cili do të hyjë në fuqi që nga Janari i Vitit 2025, ne si komunë jemi mundu që përsëri të ruajmë atë minimumin e normave tatimore të caktuara me ligj, pra për vlerën e detyrimit tatimor e cila llogaritet sipas kufijëve për vlerat deri në 100,000.00€, aplikohet shkalla tatimore prej 0.10%, sepse norma që mund të variojë 01-10%, mirëpo ne si komunë kemi propozuar që të kemi minimumin e normave, minimumin e pragut ligjor d.m.th. për norma tatimore, të cilën do t'a aplikojmë nga Viti 2025, për vlerën e pronave mbi njëqind mijë (100,000.00)euro, aplikohet shkalla tatimore prej 0.20%, sepse është minimum që lejohet me ligj, plus tatimi nga nen-paragrafi 3.1 të këtij neni, pra i shtohet edhe vlera e 10% për prona deri 100,000.00€, për vlerën e pronave mbi pesëqindmijë euro (500,000.00)euro aplikohet shkalla tatimore prej 0.30%, që përsëri është minimum i caktimit të normës ligjore, plus tatimi nga nën-paragrafet 3.1 dhe 3.2 të këtij neni, për vlerën e pronave mbi një milion euro (1,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore prej 0.40%, plus tatimi nga nen paragrafet 3.1, 3.2 dhe 3.3 të këtij neni, si dhe për vlerën e pronave mbi pesë milione euro (5,000,000.00)euro aplikohet shkalla tatimore prej 0.50%, plus tatimi nga nen-paragrafet 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4 të këtij neni d.m.th. nuk kemi më të bëjmë me llojin e pronave për çfarë natyre është e shfrytëzime, mirëpo kemi të bëjmë me vlerësim të pronave, se si janë vlerësuar pronat e qytetarëve nga ministria e financave në vitin e kaluar dhe varësisht nga vlerësimi i të hyrave do të paguajnë edhe nga Viti 2025 me këto norma progresive, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit drejtore, a dëshiron najkush të merr fjalën për këtë rend dite?, urdhëro Arian!

Arian Imeri – Drejtoresh desha vetëm me sqaru d.m.th prona mbi 500,000.00€, d.m.th.vlera 100,000.00€ tatohet me 0.10%, e tjetra mbi 100,000.00€ me 0.20%.

Sebahate Ajeti Sadiku – Për vlerën e pronave mbi pesëqindmijë euro (500,000.00) euro, aplikohet shkalla tatimore prej 0.30%, plus tatimi nga nën-paragrafet 3.1 dhe 3.2 të këtij neni, për vlerën e pronave mbi një milion (1,000,000.00) euro aplikohet shkalla tatimore prej 0.40%, plus tatimi nga nën paragrafet 3.1, 3.2 dhe 3.3 të këtij neni. E nëse jeni të gatshëm e marr edhe monitorin dhe e shofim në kuvend, i marrim të gjitha ato raste të cilat jeni të interesuar.

Arian Imeri – E kjo po i bjen për vlerën e pronave mbi një milion euro (1,000,000.00) euro, aplikohet shkalla tatimore prej 0.40%, faliminderit. Jo vetëm me na tregu realitetin se çka është tu ndodhë.

Sebahate Ajeti Sadiku – Mundemi me i marr prej secilit pronat, me ju dhanë nga një shëmbull edhe në kuvend, hiç nuk është telashe, vetëm për me u kuptu ma mirë edhe qytetarëve me ju tregu si është më s'miri dhe ta shofim se sa rritet tatami në vitin e ardhëshëm, kjo i bjen si për personat fizik si personat juridik, e kam pa që ka pas komente edhe prej qytetarëve dhe bizneseve pse do të rritet tatami, duhet me qenë të njoftum qytetarët që tatami do të bëhet si për personat fizik, si personat juridik, po që bizneset që kanë prona të vlerësime në shuma më të larta dhe kanë me

ofertu në mënyrë ma të pashme me njëfarë mënyre, edhe për neve gjithashtu, nëse një shtëpi ka paguar 25€ e prej vitit të arshëm do të paguaj 60-70€ varësisht sa është e vlerësime, në fakt Ministria për Buxhetin e Vitit 2025 na ka rritur buxhetin e Komunës së Ferizajt, po tanë kohën gradën e përgjithshme nuk e ka ngritur fare d.m.th. neve veç na ka rritur tavanin e realizimit të të hyrave, duke e rrit tatimin në pronë për 1,500,000€, nga granditë e përgjithshme nuk kemi pas rritje hiç.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit, kjo është e qartë, Dikush tjetër?

Brahim Osmani – Përshëndetje për të gjithë, nuk besoi që kjo pikë e rendit të ditës të kalojë në kuvend pa u kritikue edhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, po kuvendi e ka prurë si propozim, e ka prurë kryetari i komunës edhe kuvendi nuk ka me miratim, nëse nuk është në rregull edhe për bizneset edhe për qytetarët ju e keni shumicën, si PDK mos e votoni në Kuvendin komunal edhe mund ta kalojnë në kuvend, njëjtë si propozim kemi pasur edhe në tash një vjet, propozimin për faljen e tatimit në pronë për 100.00€, kur ju si pushtet si PDK bashkë me Kryetarin e Komunës Agim Aliun ju e keni votu propozimin tonë, për me ja falë tatimin për qytetarët e Komunës së Ferizajt, e nëse merrni shembull, ju jeni shembull për të keq, e si keni vepruar për këtë Kuvendin komunal, prandaj nëse e merrni çdo pikë dhe fjalë e juaj që të kritikohet Qeveria e Republikës së Kosovës, pra mendoi që është gabimisht dhe mendoi se duhet me pas pak kujdes se këtë propozim, e ka prurë Kryetari i komunës edhe ju e keni shumicën, keni kualicion po thuaj se me të gjitha partit, subjektet në Ferizaj dhe mos e votoni dhe mos e kaloni, por ju e keni punën për shkak të bizneseve, se asnjë ndihmë bizneseve në Ferizaj nuk ja keni ba, cila është ndihma që ju ja keni ba bizneseve në Ferizaj, asnjë ndihmë nuk ju keni ba, mos e bani këtë për shkak të dezinformimit, prandaj me pas tamam se çka po diskutohet, të paktën fjalën e parë që e jep qeveria, faliminderit.

Sebahate Ajeti Sadiku – A kanë një sqarim, unë e potencova që në fillim për këtë propozim të vendimit, Kryetari i komunës obligohet me plotësim, ndryshimin e ligjit mbi tatimin në pronë, që të bëjë një propozim të tillë, unë kërkojë falje që deri në vitin e kalim nuk e kemi zbatuar faljen e 100.00€, por e kemi ulë tatimin në pronë për të gjithë qytetarët e komunës për 33%, do të thotë se qytetarët e Ferizajt kanë paguar më pak tatim këtë vit 33% fal propozimit dhe vullnetit të Kryetarit dhe normalisht të kuvendit të cilët e kanë marrë vendimin dhe propozimin e kryetarit, nuk është çështja se qeveria po e kanë atë, e këtë, por fatkeqësisht janë dokumentet që flasin, buxheti është dokumenti kryesor i komunave edhe qeveria nuk i ka përkrahur në asnjë formë buxhetin e Komunës së Ferizajt, e ka rrit buxhetin e komunës, duke e rritur tavanin e realizimeve të të hyrave, kjo nuk është rritja e buxhetit nga qeveria, kjo është rritja e buxhetit nga vet komuna, sepse e dimë që të hyrat vetanake, sidomos tatimi në pronë janë e hyrë kryesore e komunës, nuk është çështja nëse e votojmë një çështje dhe a po i alarmojmë qytetarët apo jo, kjo është informatë të cilën e kemi të zyrtarizuar me ligj, deri në këtë vit, e kemi pas normën tatimore deri 0.10% normën minimale të tatimit në pronë, prej vitit të ardhshëm qeveria na ka obligu që ma nuk kemi mundësi ta vendosim normën tatimore deri 0.10%, nëse ka vendosur të zbatohet norma progresive e tatimit në pronë, normalisht si për persona fizikë si për ata juridik, për persona juridik ka ndikuar më shumë se kanë prona me vlera më të larta se sa personat fizik.

Arian Imeri – Na tani po e përfundojmë mandatin si punëtorë të Kuvendit komunal dhe se kologu thotë të mos aprovohet ky dokument dhe se nuk e ka marrë mësim dhe rolin që e kanë këtu, ky është ligji që është miratuar në Republikën e Kosovës dhe i cili vlenë për të gjithë dhe të gjithë kanë me

aprovu këtë dokument, na nuk mundemi mos me votu një ligjë që është miratu në Republikën e Kosovës, prandaj çka jena tu e ba na si komunë ashtë që jena tu e marr shkallën minimale të mundëshme d.m.th një shërbim më të madh, nuk mundet me ju ba qytetarëve në asnjë komunë, ka me pas edhe komuna që kanë votu edhe 1% mirëpo kjo 0.10% rasti i parë, 0.2 rasti i dytë, 0.3 rasti i tretë, 0.4 rasti i katërt 0.5 rasti i pestë, janë tarifat minimale që janë marr, duke i marr parasysh që mundet me i aprovu një komunë, nuk ka mundësi ma poshtë se është ligji mbi pronat e paluajtëshme dhe që nuk mundet me ndryshu, sa i përket çka tha drejtoresha më parë d.m.th. që jemi e vetmja komunë që e kemi aprovu faljen e taksave të bizneseve private, nuk është mirë me manipuliu, po nuk po di, a është në përfundim të mandatit apo nuk jemi në gjendje një ligj me zbatu, faliminderit.

Lulzim Abazi – Faliminderit Kryesues, lidhje me këtë që tha Ariani deshta mu dërlidhë edhe unë, ky propozim që ka ardhë dje nga Kryetari i komunës, kjo është në parlament, e që e kam përcjellë dje në seancën e Parlamentit të Kosovës, ku është vendos dhe ku është kalu me shumicë të votave, aty ka qenë kundër opozita, kundër të këtij ligjit, por me shumicë të votave, normal që është votu edhe është miratu ky ligj, prandaj po themi ka ardhë nga qeveria dhe e ka ba vijë këtë ligj, tash nuk është problem pse është qeveria e vetvendosjes, e na jemi pikërishtë tu folë për atë punë, pikërisht kundër tina po folim, ka ardhë prej qeverisë edhe po mendoj që është kështu e randë kjo për qytetarët tanë edhe pikërisht edhe për neve, faktikisht sepse jemi pjesë e këtij shteti, po du me u ndërlidh te kjo pjesa e shkallës tatimore, si vlerë nëse e marrim te kjo në vlerë 500,000.00€ te kjo 3.3 në qytetin tonë në Ferizaj janë vlerësu me sa kam pa unë vlera klogjo të mëdhaja nga Ministria e financave edhe faktikisht nëse një shtëpi është me dyqane mrena, që ka shumë në Ferizaj në vlerë 500,000.00€, atëherë 1,500.00€ që ka mu tatimu mbrenda vitit, aty do të ketë kështu shumë probleme sepse aty do të lëshohen lokalet me qira edhe krijohen probleme tjera me qiradhenësin dhe qiramarrësin, andaj e kemi edhe në Qytetin e Ferizajt, po e marr si shembull Ferizajin, është fabrika e gypave që ka një pjesë shumë të madhe të pronës aty edhe fabrika tjera që janë privatizu edhe kjo ka me ndiku negativisht sepse është vlerë e madhe, sidomos për shkallën tatimore progresive, kjo është një ide që ka ardhë tek ne edhe para kuvendit dhe se ne nuk kemi kah me ja majt, sepse veç është punë e kryme kjo, na nuk mundemi me refuzu, kot e refuzojmë edhe nëse bëhemi komplet njëzëri, komplet Kuvendi i Ferizajt nuk ja vlenë kjo punë, se nuk qonë peshë, nuk është punë që bahet, besoi se krejt na pozitë dhe opozitë kishim me ndërhy.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Dikush tjetër?, urdhëro Brahim!

Brahim Osmani – E para propozimi për tatimin në pronë për të gjithë qytetarët e Ferizajt të faljes së 100.00€, na asnjë nuk e kena propozu në mënyrë selektive, e dyta dhe kjo qeveri i ka dy mandate, e as njohurin, e as nuk u marr për ndryshimin e tatimit në pronë, por në kuvend ka kalu ligji dhe plotësim ndryshimi i tatimit në pronë, të faljes 100.00€, të faljes së tatimit në pronë në parim, po ky ligjin nuk e kap fare, as informatën nuk e kap fare, e vjenë e diskuton, e i ka dy mandate në kuvend, as nuk na ka përcjell, e as nuk e përcjellë, për këto vjet veç si propozim është dalë, që në 5 apo 6 seanca veç me kritikë qeverin, amo informata nuk ka ne qeverin e kalume, tjetra unë dhe Luli që e diskutoi një temë që në vlerën e 500,000.00€ të lokaleve edhe atyre, na duhet me kanë korrekt pak, vlera e pronave në Ferizaj ka hyp shumë, një banesë që ka qenë para 3-4 vite, qiraja ka qenë 300.00€ tash 400.00-500.00 euro, në Ferizaj normal që duhet me pagu tatim pak ma shumë edhe lokalet në qytetin tone, nuk ka lokale nën 1,000.00€ qira, pra mos thuni se Qeveria e Kosovës, vlerësimi p.sh. nëpër fshatra nëse e keni analizu dhe me i këqyrë Ministrinë e financave, që me një

formë as nëpër fshatra, e as një pjesë e qytetit se qysh janë vlerësu, veç pak drejtore, nëpër fshatra, nëpër shtëpi tokat që janë shumë pak janë vlerësu dhe nuk e kanë çmimin real, tokat që janë vlerësu, veç këqyrni nëpër fshatra, nuk kanë çmimin real se sa shiten, këtë po e them për shkak që kam këqyrë, e në qytet ndoshta ka mundësi nuk është vlerësuar mirë, 80% në fshatra nuk është vlerësuar mirë, po është ligji se nëpër fshatra me u vlerësu se qysh janë, por është mirë me e këqyrë dhe me realizue, nuk është mirë me pritë ashtu qysh e tha drejtoresha 25.00euro me pagu edhe 70.00euro, e nëse është qashtu unë nuk maj përgjegjësi në këtë KPF ose seance.

Mimoza Pajaziti - Cila është e vërteta

Brahim Osmani – E vërteta është që nuk hyp ashtu qysh po thotë drejtoresha, ku është 25% a e ki lexu, a po e sheh kryesues e kanë të pa qartë edhe drejtoresha edhe anëtarët, unë e kam analizu, kur e kam ba deklarinim e pasurisë, e kam ba në bazë të Ministrisë së financave që ka dal ma pak vlere e arit nëpër fshatra.

Mimoza Pajaziti – Nuk krahasohet Rahovica me Ferizaj.

Brahim Osmani – Veç po e them se kjo është për neve në përgjithësi, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Dikush tjetër?, udhëro Arian!

Arian Imeri - Unë po flas brenda për brenda kuvendit edhe po flas për ato 100.00€, nuk është ligj obligativ për kuvendin e komunës, nuk e di sa ishte perqinja për të gjitha pronat që po flasim këtu, do të thotë për rastin e parë, e për rastin e dytë, e të tretë, e katërt, pestë, mbi të gjitha ka qenë d.m.th. vlere e tatimit në pronë, ka qenë për rastin e parë 0.1, e për të dytin 0.2 e që i bije se është rritur 100%, e për rastin e tretë i bije 100% më shumë. Ku pe she në ligj që e dallon personin fizik edhe juridik, kjo është tatim vetëm për vlerën e pronës, t'i mundesh me pas ara dhe je person fizik dhe nuk je biznes, ki arra, e arrat e tua bajnë 1,000,000.00€ ki me pagu njejt sikur ai që e ka shumën e veqantë, i paguan 1,000,000.00€, tatimin nëse e ke lexu, nëse është pronë bujqësore flet vetëm për vlerën pa marr parasysh në të kalumen p.sh. pronat bujqësore janë larguar prej tatimit tash, çfardo prone e pa luajtëshme hynë në kuadër të tatimit edhe tatimohet varsisht prej vlerës, a ke atij apo këtij, faliminderit.

Sebahate Ajeti Sadiku – Edhe diçka kryesues, e para e punës na kemi ba vlerësimin që e ka ba ministria, e kemi ulë tatimin vitin e kalum, kemi diskutu, nuk e kemi fal 100.00€ po kemi fal ma shumë se 100.00€ qytetarëve, ja kemi ulë tatimin për 33%, në qoftëse për 1,000.00€ një tatim pagues, në vendëse ati me ju pagu 100.00€, na ja kemi fal 33% tatimin, e që i bjenë më shumë se 100.00€, sa i përket pronave, i nderuemi asambleist po thotë që nuk është rritur vlere e pronës, shembull konkret prona ime familjare është në qendër të qytetit, do të thotë në një rrugë në qytet, është vlerësu për 170,000.00€, po që deri sivjet kemi pagu 0.10%, prej vitit të ardhëshëm normal që rritet tatimi, se deri në 100,000.00€ kemi me paguar deri 10%, kurse në vlerën prej 70,000.00€ kemi me paguar 0.20%, normalisht që ka rritje, po tu kisha lut të pyesësh dhe të qartësohesh me dikand për vlerësimet dhe llogarit e sakta, pastaj të vish e të propagandosh këtu, nuk është në rregullë, sepse nuk e ki as postin e zëdhënësit të qeverisë, as avokatin nuk jena tu e pa këtu, jemi tu folë në mënyrë reale që faktikisht janë të caktueme me ligj, e kemi edhe ligjin e vjetër të tatimit në prone, por edhe e kemi edhe ligjin e ri, mundemi si kuvend mos me aprovu një vendim të tillë,

po që prap me ligjin e njejtë, d.m.th. me ndryshimin e ligjit të njejtë me nenin 9 paragrafi 5 Ministria e financave, këtë rast departamenti i tatimit në pronë, qoftë në kuvendet komunale deri 30 Nëntor nuk marrin vendime të tilla, ministria përsëri ka të drejtë me vendos limitin e tatimit të pronave të vlerësime, do të thotë nëse komuna nuk e bënë propozim të tillë të një vendimi, atëherë ministria në vitin e ardhëshëm i vendos limitet e veta pa i pyetur komunat, mundet ta përcaktoi vlerën minimale, e cila ka qenë në vlerat të propozuara në kuvend, këtë rast dihet që ministria deri 30 Nëntor nëse nuk e propozon një gjë të tillë, do ta marrin vendimin në norma minimale, apo siç kemi pasur vendimin e fundit, për ta zbatuar për Vitin 2025, merreni ose ju si kuvend aprovimin, është prap ky ligj do të hyjë në fuqi në Janarin e Vitit 2025 dhe komunat nuk do të pyten prap se prap, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Dikush tjetër?

Flamur Istrefi – Faliminderit, përshëndetje për të gjithë, atëherë po e shohë pak a shumë si çështje koncepti këtui, Qeveria ka shkuar tu e rrit normën e interesit për ata që kanë biznese më shumë, e që komuna ka fal bizneset me përqindje më shumë, po komuna qytetarëve ju ka rritur pagën dhe se që tha Luli pak më herët, po nëse 500.00€ është vlerësi prona në kuvend, po e paguajnë në 30%, e që u përmend më herët nga drejtoresha, e nëse për 500,000.00€ është përmend 0.20%, vetëm mbi 500,000.00€ e ka vlerën tjetër, e po e shohë që është gabim kjo drejtoreshë shumë thjesht, nuk kalon nga ministria dhe kjo është shenjë pakënaqësie, pra nga ana jonë duhet të themi nuk jeni në rregullë e kundërshtojmë këtë propozim edhe vendos ministria, shumë e thjesht në këtë formë.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Dikush tjetër?

Sebahate Ajeti Sadiku – Kryesues edhe diçka, te falja e kemi obligim para qytetarëve, nuk është në rregullë në qoftëse në p.sh. Tatim paguesi e ka pas obligim 50.00€, na nuk kemi mujt me ja fal 100.00€ as 50.00€ sepse është dashur që diferencën e rritjes të tatimit në pronë mos me rrit fare, se kishte me qenë më mirë, po na e kemi shfrytëzuar opcionin e fundit ligjor, e kemi ulë tatimin në pronë për 33%, kryetarët janë të informuar që kanë paguar më pak, fal propozim të kryetarit dhe aprovimit që e keni marrë ju në kuvend, kanë paguar 33% më pak po fatkeqësisht që prej vitit të ardhëshëm do të paguajnë më shtrejtë, për shkak të Ligjit të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Po më vjen shumë keq që nuk po mundeni me u koordinu për këtë propozim, nëse atëherë falja ka qenë një propozim, e nuk ka qenë ligj, komunat kanë vendos vet sipas vullnetit të qytetarëve edhe të kuvendarëve edhe të asambleistave, tani kemi propozim ligjor, secila komunë është e obligueme dhe e rregullume me planet e veta, ose me i harmonizu në bazë të ligjit, brenda të ligjit i keni limitet, mundet në maximum, edhe në bazë të këtij ligji komuna mundet me marr një vendim, nuk është kjo, a po donë a spo donë ka obligim ligjor me e implementu ligjin në parlament dhe në bazë të ligjit ky propozim mundet me u votu minimal dhe maximal, në këtë rast Komuna e Ferizajt e ka propozu kuvendit minimumin e propozimit ligjor, edhe dashëm apo nuk dashtëm, ne jem të obligum me aprovu, mujmë me aprovu ma shumë se minimum, mesatarisht ose minimalisht, nëse ne nuk e aprovojmë këtë propozim, ministria mund ta aprovoj maximumin e këtij propozimi me ligj edhe mu me më ndigju është ligj, disa ligje mundemi mi vendos me rregullore komunale, unë mendoj që propozimi është absolutisht i drejtë nuk kemi të drejtë me u marr me të kalumen qysh u kanë, e qysh su kanë, a është i drejtë a sosh i drejtë, qytetarët duhet ta vlerësojnë, po që ka ngritje absolutisht ka, dhe ky propozim për

ngritje është ligj që na nuk mundemi me e ndryshu dhe nuk mundemi me diskutu, pse kështu pse ashtu, është votu në parlament dhe jemi të obligum me e miratu, dashtëm ose nuk dashtëm, nuk kemi mu marr qysh ka qenë në herën e kalume, nëse qytetarët janë të kënaqur me këtë propozim është në rregullë, e nëse nuk janë mund të protëstojnë, po propozimi ka ardhë prej qeverisë, edhe ne jemi te obligum me miratu, a ka të interesum tjerë për diskutim?, nëse jo a jeni që të kaloi në kuvend, kush është që të kaloi në kuvend pika e IV-të?, faliminderit, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e V-të të rendit të ditës.

Pika 5

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për lirim – faljen e qirave për lokalit në Rr. “Ramadan Rexhepi” në pronësi të Komunës, drejtor a po na sqaron lidhur me këtë propozim.

Sebahate Ajeti Sadiku – Faliminderit Kryesues, në bazë të nenit 58 pika 1.h të të Ligjit, Nr. 03/L-040 për Veteqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9, të Statutit Komunës së Ferizajt 01.Nr.50, i datës 28.06.2013, Kryetari i komunës bënë këtë Propozim - Vendim për faljen e qiras të parcelës Nr. P-72217092-1-3-1-0 me adresë në Rr. “Ramadan Rexhepi” në pronësi të Komunës së Ferizajt, shuma e qiras për këtë lokal është 540.00€ në muaj dhe qiramarësi ka kërkuar që nga 01 Janari 2023 deri me datë 2024 të bëhet falja e qirasë dhe të bëhet fshirja e qiras në librat e Komunës së Ferizajt, në pa mundësi të afaroj për shkak të punimeve infrastrukturore nga Komuna e Ferizajt, pra në momentin që e ka marr kontratën pas dy tre muaj, veç kanë filluar punimet në atë zonë, edhe qiramarësi nuk ka mujt të afaroj dhe nuk ka pas punë fare edhe është detyru me e mbyll lokalit për shkak që ju ka ndërpre qasja në hyrjen kryesore. Ne kemi vullnetin që t’i ndihmojmë si biznes dhe e kemi sjellë propozimin si biznes, e kemi sjellur këtu në Kuvend, e mvaret nga ju, a do të kaloj apo jo, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit Drejtore, urdhëro Ibrahim!

Ibrahim Osmani - Faliminderit kryesues, uroi që këso propozime të mos sjellen as KK dhe as në KPF, nëse kanë ndodhë punimet në atë zonë, e nëse e marrim edhe bizneset tjera d.m.th me i fal qirat e bizneseve në atë zone, që kanë fillu punimet tjera në atë nënkalim.

Sebahate Ajeti Sadiku – Aty ku donë komuna me ndihmu, ndihmon.

Ibrahim Osmani - Nuk është ide kjo po nëse është anëtar i juvi i PDK-së mundeni me ja fal, unë mendoj se tani kanë me ardhë të kërkojnë edhe të tjerët me kërku faljen e qiras.

Sebahate Ajeti Sadiku – Është qytetar i Komunës së Ferizajt dhe ku ka mundësi Komuna me ndihmu ndihmon.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Dikush tjetër,

Flamur Istrefi – Drejtoresh a keni marr ndonjë vendim me ju letsu bizneseve tjera që është një market, e nëse nuk gabo i dy restorane, a naj subvencion apo ndonjë formë tjetër që mujmë me ju ndihmu dhe me i mbështet, mos të bëjmë vetëm një biznes me heqjen e qiras, të paktën mos të bëjmë kësi lloj selektimi, në qoftë subvencion ose diçka tjetër në pjesën që ka fillu të punohet.

Sebahate Ajeti Sadiku – Kryesues nëse më lejohet, nuk është çështje politike është qytetari i Komunës së Ferizajt, ankandi ka qenë i hapur, kanë qenë debate të hapura dhe aty ka fitu ai që ka pagu më së shprejtë qiranë, po tash në momentin që komuna ka mundësi me ba me i ndihmu bizneset, pse mos me ju ndihmu, ne subvencione nuk kemi në planifikim dhe një ndarje të tillë që t'i ndihmojmë bizneset të tjera, sepse ju e dini që edhe në pandemi i kemi ndihmu bizneset dhe i kemi ndihmu vetëm ato biznese ku kemi pas mundësi t'i falim qirat, sepse nuk kemi pas mjete financiare që t'i ndihmojmë të gjitha bizneset në përgjithsi, aty ku kemi pas mundësi, ku bizneset kanë qenë në kuadër të komunës, aty ju ka fal qiraja e bizneseve, aty ku nuk kemi pas mundësi, nuk kemi reagu edhe këtu është njëjtë, është lokali i komunës, ne ja kemi pa mundësu me projektin infrastrukturor, e që kemi filluar në atë pjesë punimet, kemi mundësi me e liru nga falja e qiras d.m.th. me ja liru nga qiraja, për biznese tjera nuk kemi mjete financiare të ndara në projesionet e buxhetit për këtë çështje, edhe pse kërkesa na ka ardhë pak me vonesë në këtë rast dhe ju e dini që buxheti është i aprovuar për Vitin 2025, mirëpo nëqoftëse jeni të pajtimit t'ia falim qiranë në këtë lokal, do ta zbatojmë, e nëse jo prap varet nga ju, nëse doni të ndihmoni apo jo, por po e potencoi edhe në kohën e pandemisë, komuna ka marr masa vetëm aty ku kemi pasur lokalet e komunës me qira, sepse aty kemi pas mundësi dhe aty kemi ndihmu, d.m.th. nuk jemi që t'i anashkalojmë bizneset e tjera, po normalisht ku mundemi të ndihmojmë aty edhe kemi vepru, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi - Faliminderit, unë e kam një pyetje, nuk jam kundër me ju falë borgjin apo obligimin që e ka një subjekt afarist, pyetja ime është?, a i vazhdohet kontrata me tutje në shfrytëzim nga komuna apo jo.

Sebahate Ajeti Sadiku – Nëse ja falim deri me 31 Dhjetor 2024 nga Janari 2025 faturohet në mënyrë të rregullt, sepse veç projekti ka përfunduar edhe biznesi do të filloi të punojë, për momentin është mbyllë, sepse qe një vit e gjysmë, nëse nuk gaboi dhe se bajagi shpesh kam kalu andej pari, nëse e kish ba shkëputjen e kontratës atëherë lokali është mbet pa pagim të qiras, d.m.th. kish mbet i mbyllur.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Bash njëjtë nuk është Drejtore, është dashtë të bëhet shkëputja e kontratës, duke marr parasysh që rasti është qysh është, unë realishtë në momentin kur ju ka ndërpre puna dhe është mbyllë lokali është dashtë të ndërprehet kontrata, se nëse kontrata ka vazhdu edhe na ja falim borgjin, pse nuk e ndërpresim menjëherë kontratën, pak e pa kuptimt, projekti nuk ka vle veç për këtë lokal, se aty ka lokale plotë, nëse të tjerëve nuk ju falet, e vetëm këtij është pak e pa drejtë, nëse ka lokale të tjera të komunës, e nëse nuk ka është i vetmi atëherë jemi në rregullë, po nëse ka, është mirë realishtë me ju fal edhe atyre.

Sebahate Ajeti Sadiku – Ky është i vetmi, ka aty edhe dy restorante po ata e kanë pas veç hyrjen aty, ky është lokal që ka qenë i vetmi që ka qenë i bllokuar aty në mënyrë totale dhe ka qenë pronë e komunës dhe këtë rast komuna mundet që ta ndihmoi këtë lokal.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Nëse nuk ka lokale tjera aty është i vetmi lokal, i pronës së komunës dhe është e vërtet se ka pas punime dhe nuk ka mujtë me punu, jemi në rregullë nëse ka tjerë.

Sebahate Ajeti Sadiku - Nuk ka, është një kërkesë aty, një restorant bash në ballin e projektit me sa jemi të informum, komuna i ka dhanë pëlqim pa pagesë mos gabofsha, një taksë formale që me

afaru te salla e sportit d.m.th në bazë të kërkesës së vet pronarit të restoratit, komuna ja ka mundësu asaj për mos me i pengu.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Dikush tjetër,

Brahim Osmani - Një sqarim, a është pronar i komunës që ka me pagu qira, po është e njejta pronë, po mendoj se nëse ka mu fal, e unë mendoj nëse falen të falen të gjitha bizneset atje, nuk ka lidhje a është e komunës edhe ai që nuk është i komunës ka me ja pagu atij qiran prej kujt e ka marr.

Sebahate Ajeti Sadiku - Kanë punu bizneset e tjera, po ky ka qenë i mbyllur vazhdimisht Brahim, në momentin që e ka marr kontratën ka punuar 4 muaj dhe ka qenë i mbyllur.

Brahim –Jo nuk ka qenë i mbyllur drejtoresh, merri kamerat edhe këqyri,

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Dikush tjetër, nëse jo a jeni që të kaloi në kuvend, kush është që të kaloi në kuvend pika e V-të?, faliminderit, 7 vota për, 2 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e VI-të të rendit të ditës.

Pika 6

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Raporti financiar për periudhën Janar – Shtator për Vitin 2024, urdhëro drejtoresh!

Sebahate Ajeti Sadiku – Faliminderit Kryesues, sa i përket Raportit financiar për të hyra dhe shpenzimet buxhetore, gjate periudhës Janar-Shtator 2024 u inkasuan gjithsej te hyra vetanake në vlerë prej 5,544,175.46€, vlera e inkasuar gjatë kësaj periudhe të këtij viti po të vëhet në krahasim me vlerën e inkasuar të Vitit 2023, ka një rënje për 21.57%, ndërsa krahasuar me realizimin e Planit të THV për Vitin 2024 kemi tejkaluar realizimin e planifikimit të të hyrave për 2.49%. Tek shpenzimet buxhetore edhe sa i përket kësaj çështjeje do të thotë me shpenzime buxhetore jena hap me kohën dhe po mendojmë se nuk do të kemi suficid, pra mjetet e shpenzuara nga grati qeveritar gjithsejt të shpenzuara 30,369,496.91€, të shpenzuara nga të hyrat vetanake janë shpenzuar 5,544,175.46€. vlera e inkasuar gjatë këtij viti është inkasuar në krahasim me vlerën e Vitit 2023 ka një rënje për 21.57%, ndërkas krahasuar me realizimin e Planit të THV për Vitin 2024 kemi tejkaluar realizimin e planifikimit të të hyrave për 2.49% edhe te shpenzimet buxhetore edhe sa i përket kësaj çështjeje me shpenzime buxhetore jemi në hap me kohën edhe për këtë nuk do të kemi suficid, mjetet e shpenzuara gjithsejt nga grandit qeveritar janë 30,369,496.91€, mjetet e shpenzuara nga të hyrat vetanake janë 5,175,158.96€, apo 83.49% te buxhetit aktual, ndërkas mjete të shpenzuara nga të hyrat vetanake dhe te hyrat e donatoreve Save The Children dhe Unioni European janë shpenzuar në vlere prej 35,589,795-96€ apo 83.49% te buxhetit aktual, në të gjitha programet dhe kategoritë buxhetore, nga Unioni European janë 40,747.14€ edhe në fund të vitit për mjete buxhetore nuk do të kemi suficid, ministria varsisht ku ka pasur suficid ju kanë nda mjete, e Komunës së Ferizajt asnjëherë nuk ju kanë nda.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Dikush tjetër, nëse jo a jeni që të kaloi në kuvend, kush është që të kaloi në kuvend pika e VI-të?, faliminderit, 7 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e VII-të të rendit të ditës

Pika 7

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për Miratimin e Strategjisë për Zhvillimin dhe Fuqizimin e Rinisë në Komunën e Ferizajt 2024-2029 dhe Plani i Veprimtimit për Rininë 2024-2027, a ka dikush të na sqaroi për këtë pikë?, drejtoresha nuk është.

Sabri Murseli – Drejtoresha nuk është, me sa e di Kryetari i ka kalu të gjitha fazat për strategji dhe është kanë mirë që të kaloj në kuvend.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Kush është që të kaloj në kuvend pika e VII-të?, faliminderit, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e VIII-të të rendit të ditës.

Pika 8

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për publikimin e listës së pronave të Komunës së Ferizajt për dhënie në shfrytëzim për Vitin 2025, udhëro drejtor!

Sabri Murseli – Kryesues, është obligim ligjor Propozim – Vendimi për publikimin e listës së pronave të Komunës së Ferizajt për dhënie në shfrytëzim për Vitin 2025, të gjithë e kemi votu në vitin e kalum, po prap kjo listë do të hynë në fuqi mbas harmonizimit me PZHK, prej Vitit 2025 prodhon efekte juridike dhe fillon të zbatohet, këtu e kam listën dhe ju përcjelli me email draftin, është mirë me i dhanë komentet e juaja, faliminderit kryesues.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – A jeni që të kaloj në kuvend, kush është që të kaloj në kuvend pika e VIII-të?, faliminderit, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e IX-të të rendit të ditës.

Pika 9

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për Këmbimin e pjesës së ngastrës kadastrale; 706-0, Z.K. Lloshkobare, pronë e Komunës së Ferizajt, me pjesën e ngastrës kadastrale 705-3 dhe 705-4 Z.K. Lloshkobare, pronë private.

Sabri Murseli – Faliminderit Kryesues edhe kjo pikë ka të bajë me këmbimin e dy pjesëve të ngastrave kadastrale; 706-0, Z.K. Lloshkobare, pronë e Komunës së Ferizajt me sipërfaqe 99 m², me pjesën e ngastrës kadastrale 705-3 me sipërfaqe 82 m² dhe 705-4 Z.K. Lloshkobare me sipërfaqe 17 m², pronë private, arsyeja është rregullimi i parcelave në atë zonë dhe qasja në atë zonë, tani na e presim vlerësimin nga ministria për këmbimin e pronave, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit drejtor, a dëshiron dikush tjetër të diskutoi, nëse jo a jeni që të kaloj në kuvend, kush është që të kaloj në kuvend pika e IX-të?, faliminderit, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e X-të të rendit të ditës.

Pika 10

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Propozim – Vendim për këmbimin e pjesës së ngastrës kadastrale; 992-0, Z.K. Talinove i Muhaxherëve, pronë e Komunës së Ferizajt, me ngastrën kadastrale 376-1 dhe 378-3 Z.K. Nerodime e Ulët, pronë e Këshillit të Bashkësisë Islame Ferizaj, drejtor urdhëro!


Sabri Murseli – Faliminderit kryesues, Propozimi i Vendimit për Këmbimin e pjesës së ngastrës kadastrale; 992-0 me sipërfaqe 33.12 m², Z.K. Talinove i Muhaxherëve, pronë e Komunës së Ferizajt, këmbëhet me ngastrën kadastrale 376-1 Nerodime e Ulët me sipërfaqe 39.83 m² dhe 378-3 Z.K. Nerodime e Ulët me sipërfaqe 32.1 m², pronë e Këshillit të Bashkësisë Islame Ferizaj, qëllimi i kësaj është ndërtimi i çerdhes në këtë zonë, është bërë vlerësimi nga ministria dhe konform vlerësimit kësaj është bërë propozimi për këtë zonë, është një projekt me ministrinë e arsimit një çerdhe lloj montazhi, faliminderit.

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Faliminderit, a dëshiron dikush të diskutoi, nëse jo, a jeni që të kaloi në kuvend, kush është që të kaloi në kuvend pika e X-të?, faliminderit, 9 vota për, 0 kundër, 0 abstenim, pra kalon, vazhdojmë me pikën e XI-të të rendit të ditës.

Pika 11

Kryesuesi i KPF-së Xhavit Zariqi – Pyetje dhe kërkesa, a ka dikush tjetër, nëse jo, me kaq po e mbylлим mbledhjen e KPF-së.

Procesmbajtësja



Zyliha Tafarshiku

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



Xhavit Zariqi